

MINISTRI

Eglantina Gjermeni ka lindur më 24 Nëntor të vitit 1968 në qytetin e Krujës.

znj. Gjermeni është diplomuar në Fakultetin e Histori- Filologjisë në vitin 1990, duke vazhduar më pas studimet pasuniversitare në Punë Sociale në vitin 1993 – 1994.

Ajo ka vazhduar studimet e mëtejshme akademike në Universitetin Grand Valley State University në Michigan, SHBA, duke marrë titullin Master në Punë Sociale në vitin 1998.

Në vitin 2005, znj. Gjermeni mori titullin Doktor i Shkencave në Punë Sociale, pranë Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës.

Nga viti 1995 deri në vitin 2008 ka qenë pedagoge në Fakultetin e Shkencave Sociale, Departamenti i Punës Sociale, ndërsa në vitet 2009-2013 ka vazhduar mësimdhënien me kohë të pjesëshme në po këtë departament.

Prej vitit 1999 deri në vitin 2009 znj. Gjermeni ka drejtuar Qendrën “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, një organizatë jo-fitimprurëse që kontribuonte në çështjet e barazisë gjinore dhe të drejtat e grave.

Znj. Gjermeni është autore dhe bashkë-autore e shumë artikujve brenda dhe jashtë vendit, studimeve dhe publikimeve që adresojnë çështje sociale, çështje të integritimit gjinor, si edhe koncepte kryesore të lidhura me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, social dhe politik.

Për vitet 2009-2013, znj. Gjermeni është zgjedhur deputete e Kuvendit të Shqipërisë. Gjatë mandatit të saj të parë si deputete, ka qenë anëtare e Komisionit të Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2013 znj. Gjermeni u rizgjodh si deputete e Kuvendit të Shqipërisë.

Prej Shtatorit të vitit 2013 znj. Gjermeni është pjesë e kabinetit të qeverisë Rama dhe deri në Shkurt të vitit 2015, mbajti postin e "Ministër i Zhvillimit Urban dhe Turizmit".

Ndërkohë që nga Shkurti i vitit 2015 dhe aktualisht mban postin "Ministër i Zhvillimit Urban".

ZV/MINISTRI

Arkitekt Gjon Radovani ka lindur në Shkodër më 08.03.1961 dhe ka studiuar në Universitetet e Heidelberg-ut dhe Shtutgartit për arkitekturë dhe matematikë.

Është diplomuar në vitin 1997 për arkitekturë duke marrë titullin “Diplom Ingenieur der Architektur”, e më pas “Master of Science” dhe “Freier Architekt”, titull i dhënë nga Dhoma e Arkitektëve të Baden-Ëürttemberg në Gjermani.

Ai është bashkëthemelues dhe drejtor i studios arkitekturore: “Architektur Stadtplanung Design” në Shtutgart, është anëtar i “Dhomës së Arkitektëve të Landit Baden-Ëürttemberg”, anëtar i komitetit organizativ, promotor dhe lektor i konferencës vjetore internacionale mbi artin sakral në Romë dhe Vjenë, themelues dhe kryetar i shoqatës humanitare, artistike dhe shkencore "Claim for Dignity", anëtar jurie në disa konkurse ndërkombëtare të design-it dhe arkitekturës, themelues i shoqatës artistike “Art Union – Albania”, etj.

Bashkëpunimet dhe punët e studios së tij në nivel ndërkombëtar si në planifikim urban, projektim arkitekturor, ndërtim dhe menaxhim, trashëgimi kulturore etj, janë ndërtuar, zhvilluar

ose ende në proces në Gjermani, Itali, Peru, Afrikë e Jugut etj. Aktiviteti i tij në Shqipëri dhe Kosovë shtrihet nga hartimi i Planit Urbanistik të qendrës së qytetit të Shkodrës, projektimi dhe menaxhimi i realizimit të disa ndërtesave polifunkionale në qendër të qytetit të Shkodrës, restaurime dhe projektme të plota në qendra kulti e trashëgimi kulturore, projektme në komplekse të ndryshme në Tiranë, projekt-manager i një qendre polifunkionale në qytetin e Prishtinës, etj.

Një specifikë tjetër e aktivitetit të arkitektit është dhe zhvillimi dhe patentimi i disa shpikjeve teknike në fushën e akustikës ndërtimore si dhe në atë të industrisë së makinave.

Në aktivitetin e tij politik vlen të përmendet kontributi i tij në krijimin e Këshillit të Parë të Huajve në rang europian në vitin 1992. Gjithashtu nga kjo periudhë deri në vitin 1996, z. Radovani ishte përfaqësues i zgjedhur me votë i të huajve në Këshillin Bashkiak të qytetit Heidelbergut.

ZV/MINISTRI

Z. Alfred Dalipi, ka lindur në Ersekë, më 6 tetor, 1970. Është i martuar dhe ka tre vajza. I diplomuar për Drejtësi dhe Gjuhë e Huaj pranë Universitetit Publik të Tiranës dhe Shkodrës. (1993 dhe 2008)

Në kuadër të formimit të pjesshëm ndër vite ka ndjekur: Administrim-Menaxhim Ndërmarrjesh; Administrim Publik, Transformimi i Ndërmarrjeve Shtetërore, në Itali dhe Francë.

Ka kryer trajnime të ndryshme mbi gazetarinë dhe menaxhimin e mediave në ShBA, Itali, Francë , Angli, Danimarkë, Gjermani etj.

Nga viti 1992 deri në 1994 ka punuar si redaktor përgjegjës pranë gazetës "24 Orë". Nga viti 1994-1998 ka punuar si gazetar pranë gazetës "Zëri I Popullit" .

Në vitin 1997 zgjidhet nga Kuvendi i Shqipërisë si anëtar - nënkryetar i Këshillit Drejtues të Radio Televizionit Publik Shqiptar, mandat i rikonfirmuar me vendim të Kuvendit të Shqipërisë edhe në vitin 1998.

Nga viti 1999 – 2005 ka punuar si zv/drejtor i Përgjithshëm i RTSH-së dhe në vitin 2000-2001 si drejtor i Televizionit Publik Shqiptar.

Nga viti 2005 – 2013 për 2 legjislatura ka qenë deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në Qarkun Korçë.

Në dhjetor të vitit 2013, emërohet Zv.ministër i Zhvillimit Urban dhe Turizmit në Qeverinë e drejtuar nga Kryeministri Edi Rama.

Është autor dhe botues i disa monografive, enciklopedive të shkurta dhe guidave njohëse mbi Shqipërinë në gjuhë të huaja : italisht, anglisht, frëngjisht , greqisht

KËSHILLTAR

Znj. Jonida Baçi ka lindur në Durrës, më datë 22 Shkurt 1978. Ajo është e martuar dhe ka një vajzë.

Znj. Baçi ka përfunduar studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës në vitin 2000.

Znj. Baçi ka një eksperiencë 13 vjeçare në fushën e menaxhimit të projekteve dhe zbatimit të programeve komplekse.

Për rreth 9 vite ka punuar pranë Zyrës së Bashkëpunimit Zviceran (SCO-A) ku ka qënë përgjegjëse për zbatimin e programeve në fushën e decentralizimit dhe demokratizimit, arsimit profesional dhe ndihmës humanitare. Ka eksperiencë në administratën publike ku ka punuar për 2 vite dhe prej vitit 2010 ka qënë përgjegjëse për komponentin kombëtar të projektit për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal DLDP, program i Qeverisë Zvicerane i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Helvetas Seïss Intercooperation prej vitit 2006.

Znj. Baçi është trajnuar në fushat e ciklit të menaxhimit të projekteve, vlerësimeve sektoriale, barazisë gjinore, menaxhimit të konfliktit dhe negociimit shumëpalesh, menaxhimit të njohurive, si dhe qeverisjes vendore dhe decentralizimit pranë disa institucioneve të rëndësishme ndërkombëtare si Instituti Teknik në Zyrih, Zvicër, Universiteti George Toën Shkolla e Biznesit në Ëashington DC, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe Akademisë së Hagës për Qeverisjen Vendore.

Ajo zotëron shumë mirë gjuhën angleze, italiane dhe në nivel mesatar gjuhën gjermane.

KËSHILLTAR

Znj. Mejvis Kola ka lindur në Tiranë, më datë 31 Korrik 1981 dhe është e martuar.

Znj. Kola ka përfunduar studimet Master Shkencor pranë Universitetit Europian të Tiranës, dega Financë Bank (diploma për tu mbrojtur në vitin 2013).

Znj. Kola u diplomua në vitin 2006 me titullin Master, në degën Grupet Etnike dhe Shoqëritë Multikulturaliste, Fakulteti i Shkencave Sociale në Universitetin e Bristol, në Mbretërinë e Bashkuar. Studimet e larta i ka kryer në Universitetin e Bristol, në Mbretërinë e Bashkuar ku u diplomua në degën Politikë në vitin 2004.

Prej vitit 2008 ka punuar prej pesë vitesh pranë Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore ku kryesisht është marrë në ofrimin e asistencës teknike dhe mbështetjes profesionale në ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimit të rolit të gruas në zonat rurale malore.

Nga viti 2006 znj. Kola ka punuar si asistente avokate në dy zyra avokatie të specializuara në çështjet e emigracionit në Neë York, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Gjithashtu, ka kryer disa trajnime pranë disa organizmave të rëndësishëm si Qendra e Trajnimeve ILO në fushën e barazisë gjinore.

Ajo zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe në nivel mesatar gjuhën italiane.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Znj. Reida Kashta ka lindur në Lushnje, më datë 1 shkurt 1981. Ajo është e martuar dhe ka dy fëmijë një djalë dhe një vajzë.

Znj. Kashta ka përfunduar studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës në vitin 2003.

Në vitin 2008 ka përfunduar Masterin në Studime Evropiane, Universiteti i Tiranës. Në vitin 2015 ka përfunduar Doktoraturën, Universiteti i Torinos, Itali, Departamenti i Drejtësisë dhe Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.

Znj. Kashta ka një eksperiencë pune prej 13 vitesh në Administratën Publike.

Në 10 vitet e fundit ka punuar në Agjencinë e Prokurimit Publik, me pozicionin Drejtoreshë e Drejtorisë Juridike dhe Monitorimit.

Ajo zotëron shumë mirë gjuhën angleze, frenge dhe italiane.

